

Vendim nr. 165 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 30 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALTIN ALUKU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-32-(12), datë 17.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuarit për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79 dhe 278, paragrafët 2 dhe 5 të Kodit Penal (KP). Mbi bazën e

këtyre akuzave Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar dosjen në ngarkim të kërkuesit për gjykim.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4084, datë 24.11.2015, ndër të tjera, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, të KP-së dhe dënimin e tij me 35 vjet burgim. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 5, i KP-së dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Në bazë të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve për disa vepra penale, dënimin e kërkuesit me 35 vjet burgim. Në zbatimin të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkuesit i ulët 1/3-ta e dënimit duke e dënuar përfundimisht me 23 vjet e 4 muaj burgim [...]”. Kërkuesi rezulton se është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 649, datë 26.04.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 4084, datë 24.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë ndryshim: Dënimin e kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, i KP-së dhe dënimin e tij me 27 vjet burgim. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, për caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e kërkuesit me 27 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të KPP-së kërkuesi dënohet përfundimisht me 18 vjet burgim [...]”. Ndaj këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-32-(12), datë 17.01.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 649, datë 26.04.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4084, datë 24.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në datën 04.05.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 15.05.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-32-(12), datë 17.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

- 6.1. *Parimi i kontradiktoritetit, e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit pa i njoftuar palët për paraqitjen e parashtimeve me shkrim dhe pa praninë e kërkuesit ose të mbrojtësit të tij. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 16.06.2017 dhe për këtë arsye ishte i detyrueshëm njoftimi i palëve. Argumentet e kërkuesit nuk janë dëgjuar njësoj si argumentet e organit të akuzës.
- 6.2. *E drejta e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka kryer rivlerësim të faktit dhe vlerësim të provave të marra gjatë gjykimit në dy gjykatat më të ulëta, duke u shndërruar kështu në një gjykatë fakti, në kundërshtim me juridiksionin ekskluziv të saj.
- 6.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai mbajtur më parë po nga ajo gjykatë për çështje të ngjashme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtuar.

9. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të

individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi i ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë plotësohet edhe ky kriter.

11. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar në këtë Gjykatë, ai i Gjykatës së Lartë, është i datës 17.01.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 04.05.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke e lidhur atë me qëndrimin e ndryshëm të mbajtur nga Gjykata e Lartë për çështje të ngjashme. Duke iu referuar këtij pretendimi, Kolegji thekson se vendimi gjyqësor bazohet, në çdo rast, në vlerësimin e rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim dhe të provave të administruara në atë gjykim. Për rrjedhojë, fakti që në rastin e kërkuarit Gjykata e Lartë ka arritur në një përfundim të ndryshëm, nuk përbën apriori cenim të parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që kërkuuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në një nga aspektet e tij, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Gjithashtu, kërkuuesi ka pretenduar se i është cenuar parimi i kontradiktoritetit, e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t’u dëgjuar, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit pa i njoftuar palët për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim dhe pa praninë e kërkuarit ose të mbrojtësit të tij. Sipas tij, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 16.06.2017 dhe për këtë arsye ishte i detyrueshëm njoftimi i palëve.

15. Për sa më sipër, duke qenë se argumenti kryesor i kërkuarit për pretendimet që lidhen me parimin e kontradiktoritetit, të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar bazohen në faktin se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë për paraqitjen e parashtrimeve për të realizuar të drejtën e mbrojtjes, Kolegji, mbështetur në parimin *iura novit curia*, do t'i shqyrtojë ato nën këndvështrimin e së drejtës së mbrojtjes. Kjo e drejtë së bashku me të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes

16. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit pa i njoftuar palët për të paraqitur parashtrimet me shkrim dhe pa praninë e tij ose të mbrojtësit të tij. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 16.06.2017 dhe për këtë arsye ishte i detyrueshëm njoftimi i palëve. Argumentet e kërkuarit nuk janë dëgjuar njësoj si argumentet e organit të akuzës.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe të kontradiktoritetit, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas nenit 436/a, pika 1, të KPP-së shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, ndërsa sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së, sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit, të paktën 30

ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.

19. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, krahas rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, është vënë në lëvizje edhe nga rekursi i paraqitur nga kërkuesi, nëpërmjet të cilit ai ka parashtruar pretendimet e tij për ndryshimin e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta. Sipas faqes së internetit të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se në datën 16.12.2022, 1 muaj përpara zhvillimit të seancës, ajo gjykatë ka bërë shpalljen për gjykimin e çështjes së kërkuesit, e cila ishte parashikuar për t'u zhvilluar në datën 17.01.2023, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Sipas akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se shpallja është bërë edhe në ambientet fizike të asaj gjykate në datën 16.12.2022. Gjithashtu, referuar akteve të dosjes gjyqësore, nuk rezulton që kërkuesi ose avokati i tij të kenë lënë adresën e postës elektronike të tyre në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, për qëllime të marrjes së njoftimeve edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së ose pikës 5 të urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve". Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e mbrojtjes, për rrjedhojë pretendimet e tij janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

20. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka kryer rivlerësim të faktit dhe vlerësim të provave të marra gjatë gjyimit në dy gjykatat më të ulëta, duke u shndërruar kështu në një gjykatë fakti, në kundërshtim me juridiksionin ekskluziv të saj.

21. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, për të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë ose të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova, të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (shih vendimet nr. 37, datë 25.04.2017; nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Në rastin konkret, sipas kërkesës, me vlerësimin që ka bërë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në paragrafin 41 të vendimit të tij, ka kryer rivlerësim të faktit, si dhe vlerësim të provave, duke u shndërruar në një gjykatë fakti, në kundërshtim me juridiksionin ekskluziv të tij. Referuar këtij pretendimi të kërkesës, Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në paragrafin 41 të vendimit të tij, ka arsyetuar: *“Në rastin konkret nga gjykata e apelit është vendosur ulja e masës së dënimit për të gjykuarin për veprën penale të parashikuar nga neni 79/dh të Kodit Penal, pa u analizuar dhe argumentuar një dënim i tillë. Nuk rezulton që ndaj të gjykuarit të ekzistojnë rrethanat lehtësuese, të cilat kanë justifikuar uljen e masës së dënimit të dhënë ndaj tij, ashtu siç janë pasqyruar në vendimarrjen e gjykatës së apelit.”*

23. Gjithashtu, Kolegji vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes, ka arritur në përfundimin se asnjë nga pretendimet e paraqitura në rekurs nga kërkesi nuk u referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të ngritura në rekurs nga prokuroria, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ato u referohen shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, pasi gjykata e apelit nuk ka zbatuar drejt ligjin penal material, konkretisht nenin 47 të KP-së, pasi nuk ka arsyetuar në lidhje me llojin dhe masën e dënimit të caktuar ndaj kërkesës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në këtë nen, duke u bërë shkak që vendimarrja e saj të jetë e cenueshme (*shih paragrafët 30-31 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

24. Për sa më sipër, duke iu referuar këtyre vlerësimeve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përfshirë edhe atë për të cilin ka ngritur pretendimin kërkesi, si edhe në tërësi të të gjithë arsyetimit dhe vlerësimit të bërë prej tij, ndryshe nga sa pretendohet nga ai, Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në asnjë moment nuk ka bërë rivlerësim të faktit ose vlerësim të provave të marra në shqyrtim në gjykatat më të ulëta. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë e ka fokusuar kontrollin e saj në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, e cila është kompetencë e asaj gjykate. Në këtë kuptim, në rastin konkret, nuk kemi cenim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për pasojë, ky pretendim i kërkesës është haptazi i pabazuar.

25. Si përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.